

VENDIM
Nr. 131, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 79/10 prot, datë 27.8.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

konstatoi se:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511 prot, datë 13.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim: i pa plotësuar. Në objektin e veprimtarisë së aplikuesit, mungon aktiviteti i tregtimit.

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është i pa plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”) plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor “d” “e”, janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. është një subjekt tregtar i regjistruar në QKB, në datën 23.12.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, që mban NUIS: L62423006M dhe statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe kapitali themeltar prej 1.000.000 lekësh referuar ekstraktit të QKB-së, zotërohet nga ortakut “ALBAVIA” sh.p.k me 10 % të kuotave dhe ortakut “ELEKTRAL” sh.p.k me 90 % të kuotave.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: “Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e HEC-eve, Batra nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, dhe transferimi i tyre në përfundim të Kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim;

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”);

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria);

- Neni 9, pika 2 germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh/sipas viteve);

- Neni 9, pika 4.8, germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti): do të kërkohej shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. të paraqesë në ERE kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti